

V E N D I M
PER DEPOZITIMIN E VENDIMIT TE PERSONIT JURIDIK

Sot me date 21 / 12 /2006, une Enkela Bajo Gjyqtare e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane pasi shqyrtova kerkesen dhe drejtorit te shoqerise "NPV" sh.a ne krijim e siper, zj Liliana Kola me qender ne Durres.
Gjate shqyrtimit ;

KONSTATOVA SE

Kerkuesi, Zj Liliana Kola, eshte emeruar ne detyren e drejtorit te shoqerise "N.P.V". sh.a Durres (ne krijim e siper) me vendimin nr 4 date 13-11-2006 te keshillit mbikqyers te kesaj shoqerise (ne krijim e siper) dhe i eshte drejtuar me kerkese Gjykates per te depozituar urdherin nr 435 te dates 13-06-2006 Per bashkimin e dy shoqerive aksionere "N.P.V. nr 3" sh.a dhe te "N.P.V. nr 4 " sh.a ne nje shoqeri te vetme | aksionerit te vetem " Ministria e ekonomise tregtise dhe energjitikes " leshuar me miratimin e perfaqesuesit ligjor me te larte Ministrit z. Genc Ruli I cili ;

Ne mbeshtetje te nenit 102 pika 4 te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise, dhe ne baze te paragrafit te pare te nenit 2 te ligjit nr 8237 date 01-09-1997 ' Per disa ndryshime ne ligjin nr 7926 date 20-04-1995 ' Per transformimin e ndermarrjeve shtetore ne shoqeri Tregtare , ndryshuar me dekretin nr 1195 date 14-08-1995, Ligjin nr 8099 date 28-03-1996 , Dekretin nr 1631 date 01-11-1996 dhe ligjin nr 8158 date 07-11-1996 dhe nenet 128, 254, te ligjit nr 7638 date 19-11-1992, Per shoqerite Tregtare , me cilesine e aksionerit te vetem (tek te dy shoqerite anonime) ka urdheruar ;

1. *Bashkimin e SH.A. "NPV nr 3 " Durres dhe SH.A.. "N.P.V. Nr 4 " Durres ne nje shoqeri te vetme .*
2. *Ekspertja Kontabel e autorizuar zj Flutura Lluka te pergatise raportin perkates ne perputhje me piken nr 1 te ketij urdheri*
3. *Ngarkohen SH.A. "NPV nr 3 " Durres dhe SH.A.. "N.P.V. Nr 4 " Durres " Durres per zbatimin e ketij urdheri.*

Ky urdher hyn ne fuqi menjehere

Po keshtu **Me urdherin nr 776 te date 01-11-2006** "Per krijimin e shoqerise SH.A. "NPV " Durres dhe crregjistrimin e SH.A. "NPV nr 3 " Durres dhe SH.A.. "N.P.V. Nr 4 " Durres. leshuar me miratimin e perfaqesuesit ligjor me te larte Ministrit z. Genc Ruli I cili ;

Ne mbeshtetje te nenit 102 pika 4 te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise, dhe ne baze te paragrafit te pare te nenit 2 te ligjit nr 8237 date 01-09-1997 ' Per disa ndryshime ne ligjin nr 7926 date 20-04-1995 ' Per transformimin e ndermarrjeve

Genc Ruli

shtetërore në shoqëri Tregtare , ndryshuar me dekretin nr 1195 date 14-08-1995, Ligjin nr 8099 date 28-03-1996 , Dekretin nr 1631 date 01-11-1996 dhe ligjin nr 8158 date 07-11-1996 dhe nenet 128, 254, të ligjit nr 7638 date 19-11-1992, Për shoqëritë Tregtare , me qëllimin e aksionerit të vetëm (tek të dy shoqëritë anonime) ka urdhëruar;

1. Krijimin e shoqërisë sh.a NPV DURRES me kapital të nënshkruar 74. 500 .000 leke (shtatëdhjetëkatërmilion e pesëqind mijë leke) i përbërë nga 74 500 (shtatëdhjetëkatërmijë e pesëqind) aksione , me vlerë nominale 1000 leke secili.
2. Të c'regjistrohen shoqëritë SH.A. "NPV nr 3 " Durres dhe SH.A.. "N.P.V. Nr 4.
3. Këshilli Mbikqyres i shoqërisë sh.a . "NPV" Durres përbëhet nga Suzana Stefa, Jeta Abazi dhe Rajmonda Boksi
4. Ngarkohen drejtorja e shërbimeve Juridike për zbatimin e këtij urdhëri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë,

Këtyre urdhërave i bashkëngjitet , akti i vlerësimit të kapitalit i kryer nga eksperti kontabel i autorizuar zj Flutura Luka, statuti i shoqërisë Aksionere "N.P.V." Durres.

Njëkohësisht kërkohet që, të regjistrohet në regjistrin tregtar një shoqëri e re që vjen nga bashkimi i dy shoqërive anonime me të njëjtin aksioner;

1. Shoqëria e re do të quhet "NPV" Durres dhe do të jetë shoqëri anonime me kapital 100% shtetëror.
2. Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë Prodhim dhe tregtim konfeksione me material porositësi .
3. Shoqëria do të ketë selinë e saj në Durres. Ajo mund të çelë degë, filiale, agjensi dhe përfaqësi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë me miratimin e organeve kompetente edhe jashtë shtetit.
4. Kapitali themelues është 74. 500 .000 leke (shtatëdhjetëkatërmilion e pesëqind mijë leke) i ndarë në 74 500 (shtatëdhjetëkatërmijë e pesëqind) aksione , me vlerë nominale 1.000 leke secili .
5. Shoqëria ka një kohezigjatje të veprimtarisë së saj pa afat të caktuar .
6. Këshilli i parë mbikqyres i shoqërisë SH.A. "NPV" Durres përbëhet nga ;

Suzana Stefa Jeta Abazi dhe Rajmonda Boksi, me vendim të këshillit mbikqyres drejtor i shoqërisë është caktuar Zj Liliana Kola dhe ekspert kontabel i autorizuar i shoqërisë është caktuar zj Marije Dushi.

7. Shoqëria e fillon veprimtarinë me nënshkrimin dhe miratimin e dokumenteve të saj themeluese.

8. Të c'regjistrohen shoqëritë aksionere "NPV nr 3 " sh.a dhe "NPV nr 4" sh.a.


Gjykates i kërkohet që mbi bazën e urdhërave të aksionerit të vetëm (tek të dy shoqëritë anonime) Ministrisë së Ekonomisë Tregtare dhe të Energjitikës të bëjë regjistrimin e shoqërisë së re "N.P.V." Durres si në regjistrin tregtar të Gjykates së Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhe të prishen pa likuidim shoqëritë SH.A. "NPV nr 3 " Durres dhe SH.A.. "N.P.V. Nr 4.

Kërkesa është e drejtë në përputhje me ligjin dhe si e tillë duhet pranuar,

PER KETO ARSYE

Duke u bazuar në ligjin nr. 7638 dt. 19-11-1992 " Për shoqëritë tregtare" dhe ligjit nr. 7667 dt. 28-01-1993 "Për rregjistrin tregtar"

V E N D O S A



1. Pranimin e kerkeses per te depozitim ne Regjistrin tregetar te Urdherit te Ministrit te Ekonomise dhe Tregtise dhe Energjitikes, Z. Genc Rruli, **urdherin nr 435 te dates 13-06-2006 Per bashkimin e dy shoqerive aksionere "N.P.V. nr 3" sh.a. dhe te "N.P.V. nr 4 " sh.a ne nje shoqeri te vetme . dhe urdherin nr 776 te date 01-11-2006 "Per krijimin e shoqerise SH.A. "NPV " Durres dhe c'regjistrimin e SH.A. "NPV nr 3 " Durres dhe SH.A.. "N.P.V. Nr 4 " Durres.**

Regjistrimin e shoqerise sh.a "NPV" DURRES ne regjistrin tregtar si nje shoqeri e re qe vjen nga bashkimi i dy shoqerive anonime me te njejtin aksioner;

1. Shoqeria e re do te quhet "NPV" Durres dhe do te jete shoqeri anonime me kapital 100% shteteror.
2. Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete Prodhim dhe tregtim konfeksione me material porositesi .
3. Shoqeria do te kete seline e saj ne Durres. Ajo mund te cele dege, filiale, agjensi dhe perfaqesi ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise me miratimin e organeve kompetente edhe jashte shtetit.
4. Kapitali themeltar eshte 74. 500 .000 leke (shtatedhjeteeekatermilion e peseqind mije leke) I ndare ne 74 500 (shtatedhjeteeekatermije e peseqind) aksione , me vlere nominale 1.000 leke sejcili .
5. Shoqeria ka nje kohezgjatje te veprimtarise se saj pa afat te caktuar .

Keshilli i pare mbikqyres i shoqerise SH.A. "NPV" Durres perbehet nga ;

Suzana Stefa , Jeta Abazi dhe Rajmonda Boksi, me vendim te keshillit mbikqyres drejtor i shoqerise eshte caktuar Zj Liliana kola dhe ekspert kontabel i autorizuar i shoqerise eshte caktuar zj Marije Dushi.

6. Te c'regjistrohen shoqerite aksionere "NPV nr 3 " sh.a dhe "NPV nr 4" sh.a.
7. Shoqeria e fillon veprimtarine me nenshkrimin dhe miratimin e dokumenteve te saj themeluese.

Urdherohet zyra e regjistrit tregatara te kryej veprimet dhe regjistrimet perkatese qe te beje regjistrine shoqerise se re "N.P.V." Durres ne regjistrin tregtar te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, dhe c'regjistrohen pa likujdim shoqerite SH.A. "NPV nr 3 " Durres dhe SH.A.. "N.P.V. Nr 4. ne kete regjister.

Kunder ketij vendimi lejohet ankim sipas ligjit.

GJYQTARE

Enkela Bajo




REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E EKONOMISE TREGTISE DHE ENERGJETKES
Drejtoria e Administrimit të Pronës Publike

URDHER

Nr. 435 Date 13.06.06

**PER BASHKIMIN E DY SHOQERIVE "NPV NR. 3" DURRES DHE
"NPV NR. 4" DURRES
NE NJË SHOQERITE VETME**

Ne mbështetje te nenit 102 pika 4 te Kushtetutës te Republikës se Shqipërisë dhe ne baze te paragrafit te pare te nenit 2 te Ligjit Nr. 8237, date 01.09.1997 "Për disa ndryshime ne Ligjin Nr. 7926, date 20.04.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore ne shoqëri tregtare", ndryshuar me Dekretin Nr. 1195, date 14.08.1995, Ligjin Nr. 8099, date 28.03.1996, Dekretin Nr. 1631, date 01.11.1996 dhe Ligjin Nr. 8158, date 07.11.1996 dhe nenet 128, 254 te ligjit Nr. 7638, date 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", me cilësinë e aksionerit të vetëm,

URDHEROJ :

1. Bashkimin e Sh.A. "NPV Nr. 3" Durrës dhe Sh.A. "NPV Nr.4" Durrës ne një shoqëri te vetme.
2. Ekspertja Kontabel e Autorizuar Zj. Flutra Lluka te pergatise raportin perkates ne përputhje me piken 1 te këtij urdhri.
3. Ngarkohen NPV Nr.3 Sh.A. dhe NPV NR.4 Sh.a .per zbatimin e ketij urdhri
Ky Urdher hyn ne fuqi menjehere.

MINISTER

GENE RULI

Adresa: Blvd."Deshmoret e Kombit" Nr.2
E-mail: smalko@mete.gov.al
Internet: <http://www.mete.gov.al>

Tely: +355 4 228467
Teli: +355 4 223158
Fax: +355 4 234052


Deklarimet e gjendjes Financiare para te Bashkimit
Te shoqerise NPV nr 3 Durres
Per periudhen 1Janar-31Gusht 2006

Nr	Emertimi I Llogarive	Gjendje me 31.08.06	
		Behet pas Bashkimit	Ishte Para Bashkimit
	Aktivi		
1	Te patrupezuara		
2	Te trupezuara	0	46.750.121
A	Toka	0	4.545.120
B	Ndertesa	0	81.902.852
C	Makineri e pajisje	0	-
D	Mjete transporti	0	-
E	Inventar ekonomik	0	131.760
f	Te tjera ne procest	0	
I	Amortizime	0	{39.829.61}
h	Provizione	0	
3	Aktive Qarkulluese	0	4.203.135
A	Inventare	0	1.181.594
B	Kerkesa per arketim	0	2.605.589
	Kliente	0	1.812.765
	Tatim fitimi	0	792.824
C	Likujditete	0	415.952
4	Llogari te tjera	0	
	Totali I aktivitet	0	50.953.256
1	Kapitalet e veta	0	49.312.548
A	Kapitali I nenshkruar	0	80.000.000
B	Prime lidhur me kapit	0	-27.600.000
C	Diferenca nga rivlere	0	10.523.742
D	Rezervat	0	
E	Fitim humb te mbart	0	-10.848.103
H	Fitim humb te ushtri	0	- 3.010.290
	Fonde te tjera te veta	0	247.199
A	Fondi I zhvillimit	0	
B	Shperblimi suplemen	0	161.059
C	Fondi I ndihmave	0	86.140
2	Detyri me pak se 1 vit	0	1.640.708
A	Furnitor uje +telekom	0	1.557.680
B	personeli	0	-
C	Sigurime shoqerore	0	53.452
D	Detyr per T.V.SH ,TAP	0	29.576
E	Detyr Buxh qerase	0	-
F	Detyr ndaj rojeve	0	-
	Totali I pasivit	0	50.953.2506



Deklarimet e gjendjes Financiare para te Bashkimit
Te shoqerise NPY nr 4 Durres
Per periudhen 1Janar-31Gusht 2006

Nr	Emertimi I Llogarive	Gjendje me 31.08.06	
		Behet pas Bashkimit	Ishte Para Bashkimit
	Aktivi		
1	Te patrupezuara		
2	Te trupezuara	0	23.864.438
A	Toka	0	1.297.440
B	Ndertesat	0	15.741.775
C	Makineri e pajisje		14.352.880
D	Mjete transporti	0	-
E	Inventar ekonomik	0	2.446.624
f	Te tjera ne procest	0	
I	Amortizime	0	{9.974.281}
h	Provizione	0	
3	Aktive Qarkulluese	0	4.070.821
A	Inventare	0	-
B	Kerkesa per arketim	0	4.040.602
	Kliente	0	3.740.904
	Tatim fitimi	0	299.698
C	Likujditete	0	30.219
4	Llogari te tjera	0	
	Totali I aktivitet	0	27.935.259
1	Kapitalet e veta	0	25.189.393
A	Kapitali I nenshkruar	0	37.000.000
B	Prime lidhur me kapit	0	-
C	Diferenca nga rivlere	0	4.902.454
D	Rezervat	0	284.753
E	Fitim humb te mbart	0	-8.913.645
H	Fitim humb te ushtri	0	-13.064.717
	Fonde te tjera te veta	0	4.980.548
A	Fondi I zhvillimit	0	4.532.696
B	Shperblimi suplemen	0	3.749
C	Fondi I ndihmave	0	444.103
2	Detyri me pak se 1 vit	0	2.745.866
A	Furnitor uje +telekom	0	-
B	personeli	0	44.370
C	Sigurime shoqerore	0	54.470
D	Detyr per T.V.SH ,TAP	0	13.505
E	Detyr Buxh qerase	0	2.523.521
F	Detyr ndaj rojeve	0	110.000
	Totali I pasivitet	0	27.935.259



Deklarimet e gjendjes Financiare te Bashkimit
Shoqeria e re
Per periudhen 1Janar-31Gusht 2006

Nr	Emertimi I Llogarive	Gjendje me 1.09.06	
		Behot pas Bashkimit	Ishte Para Bashkimit
	Aktivi		
1	Te patrupezuara		0
2	Te trupezuara	70.614.559	0
A	Toka	5.842.560	0
B	Ndertesa	97.644.627	0
C	Makineri e pajisje	14.352.880	0
D	Mjete transporti	-	0
E	Inventar ekonomik	2.578.384	0
f	Te tjera ne procest		0
I	Amortizime	{49.803.892}	0
h	Provizione		0
3	Aktive Qarkulluese	8.273.956	0
A	Inventare	1.181.594	0
B	Kerkesa per arketim	6.646.191	0
	Kliente	5.553.669	0
	Tatim fitimi	1.092.522	0
C	Likujditete	446.171	0
4	Llogari te tjera		0
	Totali I aktivit	78.888.515	0
1	Kapitalet e veta	74.501.941	0
A	Kapitali I nenshkruar	74.500.000	0
B	Prime lidhur me kapit	-	0
C	Diferenca nga rivlere	-	0
D	Rezervat	1.941	0
E	Fitim humb te mbart	-	0
H	Fitim humb te ushtri	-	0
	Fonde te tjera te veta	-	0
A	Fondi I zhvillimit	-	0
B	Shperblimi suplemen	-	0
C	Fondi I ndihmave	-	0
2	Detyri me pak se 1 vit	4.386.574	0
A	Furnitor uje +telekom	1.557.680	0
B	personeli	44.370	0
C	Sigurime shoqerore	107.922	0
D	Detyr per T.V.SH ,TAP	43.081	0
E	Detyr Buxh qerase	2.523.521	0
F	Detyr ndaj rojeve	110.000	0
	Totali I pasivit	78.888.515	0



Shenime per deklarimet financiare
Per periudhen 1Janari-31 Gusht 2006

- Te pergjitheshme

1.Per shoqerine NPV nr 3 Durres

- **Organizimi**

Shoqeria „NPV nr 3 „ eshte regjistruar ne gjykate me vendimin nr 20315 dt 18.11.98 ne baze te ligjit nr7638 dt 19.11.1992 “Per shoqerite Tregetare”si dhe ligjit nr 7667 dt 28.01.1993 “Per regjistrin tregetar“, si rezultati i transformimit te ndermarjes shteterore me te njejtin emer.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas despozitave perkatese te ligjit nr7638 dt 19.11.1992 „Per shoqerite Tregetare “, nga statuti i saj dhe legjislacioni ne fuqi.

- **Kapitali**

Shoqeria “ NPV ne 3”ka nje Kapital te regjistruar ne gjykate me vendimin nr 20315 dt 18.11.1998 per shumen 80.000.000 leke , me aksioner te vetem Ministrine e Ekonomise Tregetise dhe Energjitikes ,me vlere nominale te aksionit 1000 leke.Kapitali i nenshkruar nuk ka pesuar ndryshime qe nga dita e themelimit te saj.

- **Objekti i veprimtarise**

Objekti i veprimtarise eshte prodhim konfesionesh me fason,tregetim,eksport konfesionesh me material porositesi,blerjesh lende te para e ndihmese. Veprimtaria e saj per disa vjet me rradhe rezulton me humbje.

2.Per shoqerine NPV nr 4 Durres

- **Organizimi**

Shoqeria „NPV nr 3 „ eshte regjistruar ne gjykate me vendimin nr15128 dt 10.06.1996 ne baze te ligjit nr7638 dt 19.11.1992 “Per shoqerite Tregetare”si dhe ligjit nr 7667 dt 28.01.1993 “Per regjistrin tregetar“, si rezultati i transformimit te ndermarjes shteterore me te njejtin emer.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas despozitave perkatese te ligjit nr7638 dt 19.11.1992 „Per shoqerite Tregetare “, nga statuti i saj dhe legjislacioni ne fuqi.

- **Kapitali**

Shoqeria “ NPV ne 3”ka nje Kapital te regjistruar ne gjykate me vendimin nr 15128 dt 10.06.1996 per shumen 37.000.000 leke , me aksioner te vetem Ministrine e Financave ,me vlere nominale te aksionit 1000 leke.Kapitali i nenshkruar nuk ka pesuar ndryshime qe nga dita e themelimit te saj.

- **Objekti i veprimtarise**



Objekti i veprimtarise eshte prodhim konfesionesh me fason, tregetim, eksport konfesionesh me material porositesi, blerjesh lende te para e ndihmese. Veprimtaria e saj per disa vjet me rradhe rezulton me humbje.

- **Per Bashkimin e Shoqerive**

Bazuar ne ligjin nr 7638 dt 19.11.1992 „Per shoqerite Tregetare “si dhe ne zbatim te Urdherit te Ministrit te Ekonomise shoqerite do te bashkohen pa likujdim duke krijuar nje shoqeri te re ,me emertim te ri.

Per kete qellim u kryen veprimet kontabel per riformimin e kapitalit te nenshkruar te shoqerise se re duke perfshire ne te edhe rezervat se bashku me fondet dhe rezultatit financiar te trasheguar nga e kaluara nga te dy shoqerite.

Ne kuadrin e ketij operacioni bashkimi verifikova te gjitha llogarite perkatese te Shoqerive qe marin pjese ne te. Ne perfundim kam shprehur opinionin tim se deklarimet financiare te dt 31.08.06 nga te dyja shoqerite pjesemarese ne operacionin e bashkimit jane reale ,besnike dhe te sinqera.

Teresia e elementeve te aktivitetit dhe te pasivitetit te shoqerise se re pas bashkimit te te dy NPV-ve eshte pasqyruar ne bilancin permbledhes date 31.08.06 bashkengjitur ketij raporti.

- **Shenime per deklarimet financiare te bilancit permbledhes pas bashkimit.**

Aktivi

Aktivet e qendrueshme

Aktivet e qendrueshme pas bashkimit me vleren neto 70.614.559 leke te cilat zene 89.5% te aktiveve gjithesej, jane krijuar me kontribut te NPV nr 3 ne masen 59.2% dhe nga NPV nr 4 ne masen 30.3%.

Vleresimi i aktiveve te qendrueshme te trasheguara eshte bere ne momentin e krijimit te shoqerive sipas akteve nenligjore qe rregullojne transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregetare ,ndersa per te tjerat vleresimi eshte bere sipas kosos historike. Amortizimi eshte llogaritur sakte sipas ligjit 8432 dt 28.12.1998 si dhe duke zbatuar parimet dhe rregullat kontabel per kete rubrike.

Gjate procestit te bashkimit me vendim te Ministrit te Ekonomise u nxorren jashte perdorimit Aktive te qendrueshme me vlere te mbetur perkatesisht NPV ne 3 per shumen 1.278.597 leke dhe NPV nr 4 per shumen 13.207.113 leke.

AQT gjendje ne dt 31.08.06 jane te amortizuara ne masen 41.4% te vleres se tyre.

Aktivet Qarkulluese

Aktivet qarkulluese ne bilancin e bashkimit paraqiten me vleren 8.273.956 leke ose 10.5% te totalit te aktiveve. Ato jane krijuar me kontributte NPV nr 3 ne masen 5.3 % dhe te NPV nr 4 ne masen 5.2 %. Ato perbehen nga:

- Gjendje inventari 1.181.594 leke



- Detyrime nga qeramaresit	5.553.669 leke
- Tatim fitimi	1.092.552 leke
- Likujditete	446.171 leke

Keto aktive jane te inventarizuara ,te analizuara,te dokumentuara dhe deklaruar sipas rregullave kontabel.

Pasivi

• Kapitali i nenshkruar

Kapitali i nenshkruar i shoqerise se re ,pas kalimit ne kapital te rezervave,fondeve dhe rezultateve ne vite eshte 74.500.000 leke dhe perbehte nga 74500 aksione me vlere nominale 1000 leke per aksion,te zoteruara teresisht nga shteti Shqipetar perfaqesuar nga Ministrisa e Ekonomise Tregetise dhe Energjitikes . Ky capital eshte krijuar me kontribut teNPV nr 3 ne masen 66.2% dhe NPV nr 4 ne masen 33.8%.

Nga ana e shoqerive pjesemarese ne operacionin e bashkimit nuk eshte bere vleresimi i aksioneve sipas gjendjes reale te kapitaleve te veta.Nga perlogaritjet e vleres se aksioneve duke mare parasysh gjendjen faktike te kapitaleve te veta del se per NPV nr 3 vlefte e nje aksioni eshte 614.4 leke ndersa per NPV nr 4 eshte 680.8 leke pra raporti i kembimit te aksioneve eshte 1 me 1.1 .Shkaku i kesaj gjendje jane humbjet e medha te trasheguara nga te dyja shoqerite.

Shuma per 1.941 leke ne llogarine e rezervave eshte lene vetem per efekt te llogaritjes se numrit te aksioneve me vlere te plote .

Detyrimet e kerkuara per me shume se nje vit per shumen 4.386.754 leke jane trasheguara nga NPV nr 3 ne masen 37.4% dhe nga NPV nr nr 4 ne masen 62.6%. Detyrimet jane te analizuara dhe te dokumentuara. Problematike jane detyrimet ndaj buxhetit te shtetit per 60% e shumave te qerave te arketuara nga dhenia me qera e ambjenteve dhe qe duhet te derdhen ne buxhet.Ky detyrim eshte trasheguar nga shoqeria NPV nr 4 per shumen 2.523.521 leke.Detyrimet per uje dhe telefon paraqiten per shumen 1.557.680 leke,detyrim i vjeter ndaj rojeve per shumen 110.000 leke ,personeli 44.370 leke ,sigurime shoqerore per shumen 107.922 leke dhe T.V.Sh dhe tatim mbi te ardhura per shumen 43081 leke.

Perfundimisht ,Bilanci i celjes se shoqerise se re qe formohet nga bashkimi i dy NPV-ve Durres me dt 1.09.06 eshte hartuar konform ligjit dhe pasqyron ne menyre besnike operacionin e bashkimit.

Kapitali i nenshkruar e shoqerise se re eshte 74.500.000 leke ,i perbere nga 74500 aksione me vlere nominale 1000 leke per aksion dhe qe zoterohet teresisht nga shteti Shqipetar perfaqesuar nga Ministrisa e Ekonomise Tregetise dhe Energjitikes Se fundi shpreh se duhet bere cregjistrimi i dy shoqerive ekzistuese te NPV nr 3 dhe NPV nr 4 nga registri tregetar,si dhe regjistrimi i shoqerise se re me kapitalin e sipershenuar.

**Eksperte Kontabel e Autorizuar
Flutura Luke**





REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E EKONOMISE TREGTISE DHE ENERGJETKES
Drejtoria e Administrimit te Prones Publike

URDHER

Nr. 776 Date 01.11.96


**PER KRIJIMIN E SHOQERISE SH.A "NPV" DURRES DHE
ÇRREGJISTRIMIN E SH.A. "NPV NR. 3" DURRËS DHE
SH.A. "NPV NR.4" DURRËS**

Ne mbështetje te nenit 102 pika 4 te Kushtetutës te Republikës se Shqipërisë dhe ne baze te paragrafit te pare te nenit 2 te Ligjit Nr. 8237, date 01.09.1997 "Për disa ndryshime ne Ligjin Nr. 7926, date 20.04.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore ne shoqëri tregtare", ndryshuar me Dekretin Nr. 1195, date 14.08.1995. Ligjin Nr. 8099, date 28.03.1996, Dekretin Nr. 1631, date 01.11.1996 dhe Ligjin Nr. 8158, date 07.11.1996 dhe nenet 128, 254 te ligjit Nr. 7638, date 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", me cilësinë e aksionerit të vetëm ,


URDHEROJ :

1. Krijimin e shoqërisë Sh.A. "NPV" Durrës me kapital te nënshkruar 74,500,000 leke. i përbëre nga 74,500 aksione me vlere nominale 1000 leke secili.
2. Te çregjistrohen shoqëritë Sh.A. "NPV Nr. 3" Durrës dhe Sh.A. "NPV Nr.4" Durrës.
3. Këshilli Mbikqyres i shoqërisë Sh.A. "NPV" Durrës përbehet nga:
 - Suzana Stefa
 - Jeta Abazi
 - Rajmonda Boksi
4. Ngarkohen Drejtoria e Shërbimeve Juridike per zbatimin e ketij urdhri.
Ky Urdhër hyn ne fuqi menjëherë.

Adresa: Blvd."Deshmoret e Kombit" Nr.2
E-mail: smalko@mete.gov.al



Tel: +355 4 228467
Tel: +355 4 22158



VENDIM

Nr. 4 dt. 13.11.2006

"Per emerim ne detyre"

Ne zbatim te Urdherit te Ministrit te Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes Nr. 776 date 01.11.2006 "Per krijimin e shoqerise Sh.a. "NPV" Durres dhe çrregjistrimin e Sh.a. "NPV Nr.3" Durres & Sh.a. "NPV Nr.4" Durres; te ligjit Nr. 7638, date 19.11.1992. "Per shoqerite tregtare", i ndryshuar, dhe Statutit te Shoqerise, me propozim te Ministrit te Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes, Keshilli Mbikqyres i Sh.a. "NPV " Durres, ne mbledhjen e tij te dates 13.11.2006

VENDOSI :

1. Emerimin e Znj Liljana KOLA ne postin e drejtorit te Sh.a "NPV" Durres, me page mujore 60 000 leke.
2. Ngarkohet Drejtori i Sh.a "NPV" Durres te ndjeke te gjitha procedurat ligjore per zbatimin e Urdherit Nr.776, date 01.11.2006 "Per krijimin e shoqerise sh.a. "NPV" Durres dhe çrregjistrimin e sh.a. "NPV nr.3" Durres dhe sh.a. "NPV nr.4" Durres", te Ministrit te Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes.

Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

Kryetar

Rajmonda BOKSI

Nen/kryetar

Jeta ABAZAJ

Anetar

Suzana STEFA

